



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 82/17
Prishtinë, më 22.03.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje e Komisionit për Buxhet dhe Financa morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinothë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontić, Sali Morina dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të tjerë: Agim Krasniqi- zv Ministër i MF, Salvador Elmazi- Drejtor i Buxhetit në MF, Ismet Krasniqi-Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit - Naser Osmani.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, më datë 09.03.2017
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-157 për Ratifikimin e Marrëveshjes së financimit të Projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2018-2020;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-139 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214;
7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;

8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoi se rendi i dites miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, më datë 9.03.2017

Kryetari - konstatoi se procesverbali nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, më datë 09.03.2017 miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-157 për Ratifikimin e Marrëveshjes së financimit të Projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;

Kryetari- Qeveria e Kosovës ka dorëzuar në Kuvend Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për projektin për sigurimin e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar mes Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim. Në bazë të kësaj marrëveshje, Republika e Kosovës huazon 22 milion euro. Nga kjo shumë 15 milion euro do të huazohen për financimin e Projektit “Ndërtimi i kanalit të ujit”, e cila shumë do të nën-huazohet tek N.P.H.”Ibër-Lepenc” dhe 7 milio euro do të realizohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për financimi i projektit ndërtimi i bazenit të ujit. Kushtet e kredisë janë norma e interesit është 0.65% vjetore në shumën e tërhequr, tarifa e shërbimit prej 0.75% vjetore, si dhe tarifa e zotimit prej 0.5% vjetore. Kthimi i kredisë do të filloj në tetor të vitit 2021 dhe do të përfundoj me 15 prill 2022, kthim ky që do të bëhet me 40 këste apo dy këste në vit.

Shqipe Pantina - theksoi se në mbledhjen e kaluar si Ministri e Financave keni premtuar se do ta sjellni listën e borxheve publike, por nuk e di a e keni sjelluar, nuk është shpërndarë? Sa i përket marrëveshjes në fjalë, kredia nuk është e keqe në parim, por problemi është në qasjen e këtyre kredive. Janë disa kredi që janë miratuar në kohën e fundit, që e kanë maturim 20 vite e kjo do të thotë që po i funksionim borxhe e dy apo tri qeveri tjera të ardhshme. Kryesisht projektet që financohen përmes këtyre kredive janë infrastrukture, për të cilat mendojë që Qeveria ka mund të kërkojë edhe fonde apo grante tjera për financim, siç janë edhe fondet nga IPA, për të cilat duhet aplikuar dhe përgaditur mirë kërkesat dhe projektet dhe në konferencat lidhur me këto fonde është thënë se Kosova është ndër vendet që më së paku përfiton nga këto fonde. Ndërkaq në anën tjetër po marrim shumë kredi, që javën e kaluar i kemi marrë 120 milion euro dhe nuk e di sa është e drejtë me i futë borxh gjeneratat e ardhshme dhe qeveritë tjera kanë me qenë të detyruar me pague më shumë borxhe se sa me mendu me investue diçka tjetër.

Shukri Buja- shprehi shqetesimin se jemi futur shumë në borxh pasi që herën e kaluar i kemi kaluar marrëveshje në vlerë prej 180 milion euro tani me këtë marrëveshje plus 50 milion euro dhe kjo dëshmon se këtë vit mjaftë shumë jemi futur në borxhe dhe për gjeneratat e ardhshme do të jetë mjaftë problematike. Në marrëveshjen që po diskutojmë është një projekt i rëndësishëm për ujin por edhe në zhvillimin e bujqësisë, por nga përlogaritjet që kemi bërë borxhet publike janë rritur shumë sidomos këtë vit.

Kryetari - ajo që vlenë të përmendet është fakti se ne përmes ndryshimeve ligjore kemi miratuar një mekanizëm që lejon futjen në borxhe publike deri në 30% të bruto produktit vendor dhe kjo ka të bëjë me investime kapitale. Në seancën e kaluar kemi miratuar në Kuvend disa disa marrëveshje që arrijnë vlerën 181 milion euro, por duhet pasur parasysh se ato marrëveshje kanë qenë marrëveshje kornizë, por nuk janë mjete që drejtëpërdrejtë hyn në borxhe, edhe pse ka pasur huazime dhe borxhe të mira e

sidomos me Hungarinë që ka qenë me normë 0 %. Por kjo marrëveshje që po shqyrtojmë sot është shumë e rëndësishme pasi që ka të bëjë në financimin e rregullimit të kanalit të ujit.

Agim Krasniqi – theksoi se qështja që trajtohet me këtë projektligj ka të bëjë me një projekt të cilësisë nacionale në funksion të sistemit të ujitjes në Ibër-Lepenc. Vlera e kasaj kontrate është 22 milion euro. Ky projekt do të ndahet në dy pjesë, pjesa e parë është 15 milion euro dhe ka të bëjë me ndërtimin e rezervuarit të ujit dhe lidhjen e tij me sistemin e ujitjes dhe kjo shumë do të nënshkruhet tek Ibër Lepenci dhe pjesa e dytë është prej 7 milion euro dhe ka të bëjë me situata emergjente kryesisht ka të bëjë në të ardhmen.

Safete Hadërgjonaj - po shohim cilat janë kushtet e kësaj marrëveshje. Unë e di që qeveria ia ka vu si prioritet, sidomos në kanalet e ujitjes, në sistemin e ujit dhe ujësjellës. Në këtë drejtim më intereson a ka diskutuar ndonjëherë Qeveria dhe ka ndonjë projekt për të rregulluar sistemin e ujitjes në komunën e Pejës, Deqanit, Junikut, Istogut, Klinës, ku këtu sistemi i ujitjes është jashtë çdo niveli dhe nuk ka as kanale të hapjes dhe asnjë gjë. Pra a ka ndonjë projekt në këtë drejtim në këto zona që janë mbi 5000 hektar tokë bujqësore me cilësi të mirë të tokës apo po përqëndrohemi vetëm në këto dy sisteme të ujitjes, në Ibër Lepenc dhe Radoniq?

Enver Hoti- kerkoi më shumë sqarime për nën-huazimin e mjeteve tek ndërmarrja e Ibër-Lepenci?

Kryetari – pyeti përse nuk po shfrytëzohen fondet e IPA-së dhe nuk po përgadisim projekte të duhura për ti shfrytëzuar të gjitha ato fonde që po ndahen për ne?

Agim Krasniqi - sa i përket prioritetëve të investimeve është përgjegjësi e ministrive të linjës për tu përgjigjur më saktë për prioritetet brenda sektorëve. Sa i përket investimeve në sistemin aktual të ujitjes është me rëndësi sistemet aktuale me i vë në funksion, siç është ai i Radoniqit e Ibër-Lepencit. Në lidhje me nënhuazimin e mjeteve, kjo donë të thotë se qeveria është garantuese e kredisë, ndërsa mjetet kthehen nga ndërmarrja që i nënhuazon. Sa i përket fondeve të IPA-së janë të natyrës tjetër dhe janë për projekte tjera.

Kryetari – propozojë që ti rekomandohet Kuvendit për miratimin e Projektligjit dhe ratifikimin e marrëveshjes.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.05/L-157 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit të Projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-139 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari – theksoi se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Të rekomandojmë se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni me shtatë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214

Kryetari – theksoi se projektligji nuk përmbanë implikime buxhetore shtesë. Për këtë projektligj nuk amendamentet të propozuara nga komisioni funksional. Të rekomandojmë se projektligji nuk përmbanë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

Projektligji Nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214, nuk përmbanë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryetari – projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë, por amendamentet e komisionit funksional përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Konkretisht amendamenti 11 dhe 16 janë ato që kanë krijuar koston buxhetore shtesë, sepse është propozuar që të krijohet një Qendrat shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve dhe krijimi i grantit specifik për komunat që do të përdoret për këtë qëllim. Unë mendojë se duhet të krijohet një grup punues që të analizojë këto propozime dhe pastaj të raportojë në komision.

Agim Krasniqi - grandet janë të percaktuara me Ligjin e financave të pushtetit lokal dhe duhet pasur kujdes që mos të merren veprimet të cilat janë të pa implementueshme.

Besa Gaxherri - edhe pse nuk jamë shumë e informuar me projektligjin, por nga ajo që kuptova, bëhet fjalë për themelimin e qendrave për mbrojtjen e fëmijëve, që mendojë se është mjaftë e rëndësishme pasi që janë në interes të mbrojtjes së fëmijëve. Ndërkaq, ajo që ka nevojë për diskutim është se a duhet të krijohen këto qendra në nivel komunal apo si një qendër në nivel qendror.

Kryetari - duhet definuar një qendre në nivel të Kosovës apo pesë qendra në regjione. Nuk duhet të krijojmë qendra ku nuk ka fëmijë dhe për këtë kërkohet hulumtime. Prandaj, grupi punues të analizojë propozimet dhe të paraqet raportin me rekomandime në komision.

Shukri Buja – theksoi se duhet të kemi parasysh se ekzistojnë shumë ligje të miratuar që komunat nuk mund ti zbatojnë për shkak të ngarkesave buxhetore, dhe duhet pasur kujdes që mos të krijojë përgjegjësi për komunat që nuk e kanë koston buxhetore pasi që bëhen të pazbatueshme.

Kryetari – propozojë që të formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit dhe amendamenteve të komisionit funksional, me këtë përbërje: Besa Gaxherri (kryesuese), Labinotë Demi – Murtezi dhe Shqipe Pantina.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- I. Themelohet Grupi Punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr.05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me këtë përbërje: Besa Gaxherri (kryesuese), Labinotë Demi – Murtezi dhe Shqipe Pantina.
- II. Grupi Punues deri në mbledhjen e radhës, përgadit raportin me rekomandime për komisionin.

5. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2018-2020

Kryetari e kemi kornizën afatmesme të Kuvendit që kemi bashkpunuar me grupin punues.

Ismet Krasniqi – sa i përket KASH-it të Kuvendit 2018-2020 kemi punuar bashkarisht me grupin punues dhe për vitin 2018, kërkesat shtesë për mallra dhe shërbime për programin anëtarët e Kuvendit kërkesa është që të shtohen 493,000 euro dhe atë si vijon: 300,000 euro për lutjet e mëngjesit, 100 laptop për legjislaturën e re, 93,000 mi euro për aktivitete të tjera të deputeteve. Tek programi i administratës kemi të parapra 20 të punësuar me një shtesë prej 186,386 euro në paga dhe mëditje, stafi mbështetës politik është kërkesa për 30 punëtorë dhe prej tyre 15 këshilltar në grupet parlamentare dhe 15 asistentë për kryetarët e komisioneve dhe shuma shtesë që kërkohet për këta punëtor është 300,000 euro. Përveq kërkesave që jemi dakorduar me grupin punues, kemi edhe një kërkesës prej 350,000 euro për sigurimet shëndetësore të të punësuarve në Kuvend. Kjo është një qështje që është ngritur edhe në Kryesinë e Kuvendit.

Kryetari – pyeti se a është trajtuar Rregullorja e re e Kuvendit që është duke u punuar, respektivisht implikimet buxhetore të saj me KASH?

Ismet Krasniqi – sqaroi se në hartimin e KASH-it më shumë jemi bazuar në planin e rregullimit të Kuvendit se sa në Rregulloren e re. Implikime të caktuara direkt nuk ka, por zbatimi i MSA-së ka krijuar angazhime shtesë, si në organizimin e samiteve etj, të cilat nuk ke mundur ti trajtojmë në KASH, por do të mundohemi ti parashohim gjatë hartimit të buxhetit për vitet veq e veq.

Labinote Demi Murtezi – në takimin e grupit punues e kemi bërë një ndryshim sa i përket shprehjes në anglisht dhe nuk qenka përfshirë në dokument. Sa i përket asistentëve jemi pajtuar, por ajo qka ka qenë më diskutabile me e diskutue është mënyra e shpërndarjes së subvencioneve të Kuvendit.

Shqip Pantina - subvencionet për mua janë të papranueshme se e kemi një Ministri që merret me subvencione dhe është Qeveria që ofron subvencione dhe jo Kuvendit. Unë asnjëherë nuk pajtohe që Kuvendi me nda subvencione. Sa i përket sigurimeve shëndetësore jam dakord jo veq për deputetë por

edhe për stafin. Kam një pyetje qfarë po ndodhë me ndërtesën e Gërmisë? Shpenzimet për automjete i kisha arsyetuar, po ajo që nuk po më pëlqen është planifikimi fiksë i shumave për çdo vit. Po ashtu më intereson të dijë a janë planifikuar mjetet për digjitalizimin e arkivës dhe bibliotekës?

Enver Hoti - theksoi se renovimi i ndërtesës a kryhet ndonjëherë, dhe për vitin 2018 i paskit paraqitur 360,000 euro, dhe ky renovim po lenë një dilemë dhe unë nuk do të votojë këtë. Sa i përket subvencioneve ne më herët nuk jemi pajtuar që Kuvendi me pas subvencione dhe ju i paskit parashikuar 140,000 eur për çdo vit dhe nuk e dijë se qka i duhen Kuvendit një shumë kaq e madhe?

Besa Gaxherri – nëse krahasojmë shpenzimet sipas programeve, siç është rasti për stafin mbështetës politik përgjat viteve, buxheti është rritur dukshëm. Në vitin 2015, buxheti për stafin mbështetës politik ka qenë 533,408 euro, në vitin 2016 është rritur 633,000 euro, në vitin 2017 është 660,000 euro, kurse planifikimet për vitin 2018 janë 1.9 milion euro dhe kjo për mua është e papranueshme në vitin 2018. Numri i të punësuarve për komisione nuk është dashur të jetë në programin e stafit mbështetës politik, pasi ata do të jenë staf i administratës që mbështet çdo komision. Sa i përket subvencioneve kam qenë kundër dhe duhet të rishikoni këtë pozicion dhe duhet me na dhënë arsyen satkë për qfarë janë të nevojshme subvencionet e Kuvendit?

8 Të ndryshme

Kryetari – propozojë që themelohet Grupi Punues për të diskutuar me Ministrin e Financave rreth nevojë së rregullimit ligjor të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat për themelinin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Bali Muharremaj.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni themeloi Grupi Punues për të diskutuar me Ministrin e Financave rreth nevojë së rregullimit ligjor të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat për themelinin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Bali Muharremaj.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani